

SA TAKSA PAGAUNE
SHQIPTARET?



MT

MBZHR

MSHMS

MF

MM

MB

MEI

MEPJ

MASR

MD

7

8

9

÷

%

MK

4

5

6

×

-

FSHI

1

2

3

+

=

SHTO

0

00

.

RAPORT MONITORIMI

Tetor-Dhjetor 2022



AUTOR

ILDA METHASANI

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

Hyrje	1
1. Historiku i sistemit tatimor në Shqipëri	2
1.1 Periudha historike 1912-1944	3
1.2 Periudha historike 1945 – 1990	5
1.3 Periudha pas vitit 1991	5
2. Mbledhja dhe shpërndarja e taskave në Shqipëri	6
3. Informimi mbi taksat e vendit	8
3.1 Llojet e taksave dhe tarifave	8
3.2 Qytetarët përballë taksave	10
4. Paketa fiskale 2023	12
5. Përfundime	17

“Tatimet janë çfarë paguajmë për një shoqëri të qytetëruar”

Oliver Holmes

Hyrje

Sistemet moderne fiskale u shfaqën në Europën Perëndimore dhe Amerikën e Veriut gjatë gjysmës së shekullit që pasoi revolucionin francez dhe atë amerikan. Megjithëse tatimet moderne mbi të ardhurat dhe mbi konsumin nuk ekzistonin akoma, nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë u themelua kuadri bazë ligjor për vendosjen e tatimeve dhe rreth një shekull më vonë, do të kishim një rritje të paimagjinueshme të të ardhurave fiskale që do të ndodhte gjatë dhe pas Luftës së Parë Botërore¹.

Njësitë vendore dhe qeverisja qendrore e kanë të nevojshme përdorimin e mjeteve financiare, pra përdorimin e parave, të cilat shërbejnë për të paguar kostot e veprimtarive institucionale që entet publike duhet të kryejnë për të zbatuar detyrat që i kërkon ligji.

Për shumë njerëz, fjala "taksa" shkakton menjëherë një ndjesi negative. Kjo ndodh për arsye të ndryshme, në varësi të kontekstit ekonomik dhe social të një vendi.

Janë të paktë qytetarët të cilët kanë informacion mbi taksat dhe rëndësinë tyre. Shpeshherë ky informacion është sipërfaqësor dhe i bazuar në perceptime apo i krijuar si "opinione". Shumica e qytetarëve i shohin taksat si një "anagazhim" që duhet kryer. Në vendin tonë, qëndrimi që kemi ndaj taksave shkon përtej mungesës së edukimit apo informimit. Në mënyrë bazike, secili e di rolin dhe funksionin e taksave por historiku jo shumë i gjatë dhe i qëndrueshëm i sistemit tatimor në vendin tonë apo edhe mungesa e besueshmërisë ndaj sistemit, pra mënyra si menaxhohen taksat, kanë ndikim mbi qëndrimin e qytetarëve ndaj taksave.

Popullsia e një vendi është e detyruar të paguajë taksa, por edhe ka të drejtë të dijë se ku shkojnë paratë e taksave. Duhet të ketë transparencë të vazhdueshme mbi të dhënat se sa taksa janë mbledhur për periudhën e mëparshme, por edhe të cilësohet se ku dhe sa u shpenzuan. Shteti ka të drejtë të kërkojë pagesën e taksave, por nga ana tjetër është i detyruar të mbajë përgjegjësi për shpërndarjen e duhur të fondeve. Në momentin që rritet niveli i informimit dhe i transparencës, rritet besimi dhe si rrjedhim eficaenca e sistemit tatimor në një vend.

¹ Taksimi, leksione të përditësuara për sistemin tatimor shqiptar, 2018

1. Historiku i sistemit tatimor në Shqipëri

Rrugëtimi i sistemit tatimor në Shqipëri është ngushtësisht i lidhur me sistemet ekonomike dhe politike që ka kaluar vendi në më shumë se 100 vjet. Sipas një shkrimi të përgatitur nga "AL-Tax"², sistemi fiskal dhe financiar (tatimor) i Shqipërisë mund të ndahet në disa periudha historike në këtë rrugëtim të shtetit të pavarur shqiptar:

1. Krijimi i shtetit shqiptar dhe qeverive pas tij 1912-1944;
2. Pezullimi i sistemit tatimor (1945-1990);
3. Rifillimi i sistemit modern tatimor (pas vitit 1991).

Viti	Periudha	Përshkrim
1912	Shteti i ri pas shpalljes së pavarësisë së vendit	Baza kryesore e të ardhurave të shtetit të ri shqiptar ishin tatimet e drejtpërdrejta. Këto tatime u trashëguan nga sistemi i mëparshëm (Perandoria Osmane).
1924-1939	Sistemi tatimor i Republikës së Parë dhe Mbretërisë	U morën masat për mbledhjen e detyrimeve tatimore të prapambetura, u krye organizimi administrativ, dhe përsosja e sistemit tatimor. Gjithashtu u hodhën themelet e evidentimit dhe mbajtjes së dokumentacionit për tatimet.
1945-1976	Roli i sistemit tatimor në dobësimin e pronës private	Pushteti i tatimeve fillimisht u përdor, si një instrument politik dhe ekonomik për zbatimin e tatimeve progresive mjaft të larta mbi të pasurit (deri 80%), kufizimin e marrëdhënieve kapitaliste, dobësimin e fuqisë ekonomike të borgjezisë dhe krijimin e sistemit të ri të marrëdhënieve socialiste.
1977-1990	Roli i sistemit tatimor në zhdukjen e pronës private.	Me miratimin e Kushtetutës të vitit 1976, nëpërmjet sistemit tatimor u realizua objektivi i zhdukjes së pronës private. Shqiptarët paguanin tatime dhe taksa, të cilat ishin të "kamuflluara" në çmimet e centralizuara të mallrave

² AL-Tax, 2012. Aksesuar online në linkun: [TATIMET SHQIPTARE NË 100 VITE \(1912-2012\) - Revista Monitor](#)

		dhe shërbimeve që furnizoheshin nga sektori shtetëror dhe kooperativist i ekonomisë.
1991	Aktet e para ligjore për vendosjen e sistemit tatimor	Parlamenti, në janar 1992, miratoi një paketë ligjore tatimore, e cila krijoi bazën e nevojshme ligjore në fushën e tatimeve dhe taksave.
Janar 1992	Hartimin e legjislacionit tatimor në vend	Legjislacioni tatimor, i cili filloi të zbatohej në vitin 1992, mund të konsiderohet si themeli i sistemit tatimor modern.
14 korrik 1992	Nxjerrja e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat"	Sistemi i ri tatimor u hartua duke u mbështetur në nxjerrjen e tatimeve me mënyrë direkte dhe indirekte.

1.1 Periudha historike 1912-1944

Shteti i ri pas shpalljes së pavarësisë së vendit, trashëgoi një sistem tatimor të prapambetur dhe vendi karakterizohej nga një paqëndrueshmëri politike dhe mungesës së një administrate të fortë. Gjatë kësaj periudhe, rëndësi të veçantë pati grumbullimi i të ardhurave tatimore, në arkën e shtetit të ri shqiptar, duke i dhënë fund transferimit të tyre tek Perandoria Osmane.

Baza kryesore e të ardhurave të shtetit të ri shqiptar ishin **tatimet e drejtpërdrejta**. Taksat e trashëguara përbëheshin nga disa lloje taksash:

- E dhjeta (*tatimi që merrej mbi prodhimet e tokës, zinte vendin e parë në të ardhurat fiskale*);
- Xhelepi (*tatimi mbi blegtorinë, zinte vendin e dytë në strukturën e të ardhurave fiskale*);
- Vergjia (*tatimi mbi ndërtesat dhe trojet*);
- Angaria (*detyrim i personave fizikë ose me pagesë për punime në rrugë*);
- Tatim fitimi (*tatim i paguar nga tregtarët, zejtarët, industrialistët dhe profesionistët mbi të ardhurat e realizuara*);
- Taksa e patentës (*tatim mbi fitimin e shtresës së pasur të tregtarëve, sipërmarrësve, zejtarëve*).

Sistemi tatimor i Republikës së Parë dhe Mbretërisë (1925-1939)

Në vitin 1925, ndër hapat e para që mori regjimi për ritjen e shpejtë të të ardhurave shtetërore ishin masat për mbledhjen e detyrimeve tatimore të prapambetura të viteve 1912-1924. Menjëherë u krye organizimi administrativ dhe në bazë të këtij organizimi, vendi u nda në prefektura, ku çdo prefekturë kishte dy a më shumë nënprefektura, të cilat përfshinin disa komuna.

Politika ekonomike dhe fiskale karakterizohej nga orientimi drejt një ekonomie të "dyerve të hapura" ndaj kapitalit dhe bankave të huaja. Qeveria u dha me koncesion shoqërive të huaja 23% të truallit të Shqipërisë. Shoqëritë e huaja patën lehtësi tatimore të mëdha dhe përjashtime nga taksat. Sistemi tatimor që zbatoi shteti shqiptar gjatë këtyre viteve ndahej në tre grupe të mëdha:

- Tatimet e drejtpërdrejta (*E dhjeta; Xhelepi; Vergjia; Tatimi mbi fitimin; Tatimi mbi të ardhurat dhe trashëgiminë; tatimi mbi prodhimin e pyjeve dhe guroreve*);
- Tatimet e tërthorta, me peshë kryesore në buxhet (*Tatime të zhdrejta mbi konsumin; Të ardhura nga monopoli shtetëror*);
- Taksat e zhdrejta mbi konsum (*taksa e pijes dhe lejen e shitjes, taksë konsumi dhe të hyra doganore*).

Rëndësi të veçantë pati hartimi dhe miratimi i parimeve bazë të taksave, të cilat u shpallën nga "Statuti themeltar i Mbretërisë Shqiptare", i cili vendosi parimet bazë të sistemit tatimor sipas përcaktimit që "taksa është një detyrim i popullit për t'i bërë ballë shpenzimeve të përgjithshme të shtetit. Asnjë taksë, e çdo lloji qoftë, nuk mund të caktohet dhe të mbledhet veçse me ligj". Gjithashtu u hodhën themelet e evidentimit dhe mbajtjes së dokumentacionit për tatimet, ku funksionon edhe ekspertiza kontabël.

1.2 Periudha historike 1945 – 1990

Kjo periudhë fillon me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore dhe përfundon me rënien e regjimit komunist.

Sistemi tatimor përmbante sistemin e taksave qendrore dhe lokale, të cilat ishin të detyrueshme, të caktuara me ligj, që derdhen në buxhetin e shtetit, në shumën dhe në afatin e caktuar. Në sistemin e tatimeve qendrore përfshiheshin tatimet e mbledhura nga popullsia, e cila për efekte taksimi, klasifikohej në bazë të vendbanimit në popullsi që banon në qytet dhe fshat.

- Në sistemin e tatimeve qendrore të qytetit përfshiheshin tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e tregtarëve, zejtarëve dhe personave të ngjashëm me to; tatimi mbi të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet plotësuese të punonjësve; tatimi mbi të ardhurat nga beqarët dhe tatimi mbi të ardhurat nga të martuarit me fëmijë.
- Në sistemin e tatimeve qendrore të fshatit përfshiheshin tatimi mbi të ardhurat nga ekonomitë bujqësore individuale; tatimi mbi të ardhurat nga kulakët; tatimi mbi të ardhurat nga oborret e anëtarëve të kooperativave bujqësore; tatimi mbi pijet alkoolike.

Përveç tatimeve të qytetit dhe fshatit janë zbatuar edhe disa lloje taksash:

- me karakter lokal, si taksa mbi zotëruesit e mjeteve të transportit (automjete, motoçikleta, biçikleta, karro etj.); taksa mbi kafshët e trasha; taksa e tregut dhe peshëmatjes; taksa e pastrimit; taksa e ushtrimit të profesionit dhe taksa e akteve dhe pullës.

Me miratimin e Kushtetutës të vitit 1976, nëpërmjet sistemit tatimor u realizua objektivi i zhdukjes së pronës private. Shteti me politikën tatimore dhe sistemin e ngritur, propagandonte se Shqipëria ishte i vetmi vend në botë pa tatime dhe taksa. Megjithatë, shqiptarët paguanin tatime dhe taksa, të cilat ishin të "kamuflluara" në çmimet e centralizuara të mallrave dhe shërbimeve që furnizoheshin nga sektori shtetëror dhe kooperativist i ekonomisë.

1.3 Periudha pas vitit 1991

Në Shqipëri, aktet e para ligjore për vendosjen e sistemit tatimor fillesën e tyre e kanë në vitin 1991, periudhë që përkon me **hartimin e legjislacionit tatimor** në vend, i cili u konkretizua me shpalljen e tij në janar të vitit **1992**, dhe më pas me nxjerrjen e ligjit "**Për tatimin mbi të ardhurat**" më **14 korrik 1992**. **Legjislacioni tatimor, i cili filloi të zbatohet në vitin 1992, mund të konsiderohet si themeli i sistemit tatimor modern.** Sistemi i ri tatimor u hartua duke u mbështetur në nxjerrjen e tatimeve me mënyrë direkte dhe indirekte.


- a. tatime direkte (tatimi mbi fitimin, tatimi mbi biznesin e vogël dhe taksat)
- b. tatime indirekte (tatimi mbi qarkullimin (zëvendësuar nga TVSH), akciza dhe taksat doganore).

Vitet e fundit, politika fiskale e mbledhjes së të ardhurave të buxhetit është mbështetur mbi nivelet e administrimit në: nivel qendror me dy agjencitë kryesore që janë:

- a. administrata tatimore qendrore dhe administrata doganore;
- b. niveli lokal me rrjetin e administratave tatimore vendore.

2. Mbledhja dhe shpërndarja e taskave në Shqipëri

Shumë pak qytetarë kanë informacionin se sa është vlera e taksave që akumulohen në vit, dhe ku kanalizohen këto taksa. Le të ndalemi fillimisht tek shpenzimet e buxhetit (të planifikuara dhe faktike) të vitit 2021, për të kuptuar fushat prioritare. Sipas treguesve fiskal të konsoliduar, rezulton se shpenzimet gjithsej në ligjin e buxhetit 2021 janë planifikuar 628.3 miliardë Lekë dhe janë realizuar 596 miliardë Lekë ose në masën 94.8%, me një mos realizim prej 32.3 miliardë lekë.



Nëse i referohemi grafikut, sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është “Mbrojtja Sociale”, me 30% të shpenzimeve publike në vitin 2021, ku mbulohen programe si fondi i pensioneve, mbështetja e familjeve dhe individëve në nevojë. Kategoria “Shërbime të përgjithshme publike” në planifikim përbënte 6% të shpenzimeve, ndërsa në realizim 15% të shpenzimeve buxhetore të konsoliduara.

Për vitin 2021, funksionet “Çështjet ekonomike” dhe “Strehimi komoditetet e komunitetit” (fondet e rindërtimit) zënë respektivisht 11% dhe 12% të totalit të shpenzimeve të realizuara në buxhetin e konsoliduar. “Shëndetësia” dhe “Arsimi” përbëjnë respektivisht 11% dhe 10% të shpenzimeve publike. “Rendi dhe Siguria Publike” me 6%,

“Mbrojtja” 2%, “Argëtimi, Kultura dhe Çeshtjet Fetare” dhe “Mbrojtja e mjedisit” me vetëm 1% secila.

Planifikimi dhe realizimi (fakti) i shpenzimeve buxhetore sipas funksioneve kanë ndryshime të konsiderueshme, pasi kategoria “Shpenzime të tjera të paklasifikuara”, ku përfshihen shpenzimet e pushtetit vendor, pagesat e borxhit, fondet rezervë dhe fondi i rindërtimit, rishpërndahet midis funksioneve gjatë vitit.

Ndryshimin më të lartë për vitin 2021 e ka funksioni “Mbrojtja e Mjedisit”, me një realizim 440% kundrejt planit fillestar. Funksione të tjera që kanë shmangie të konsiderueshme mbi planin janë “Shërbimet e Përgjithshme Publike” me 262% realizim ndaj planit, ku përfshihen pagesat e borxhit, si dhe Strehimi – Komoditetet e Komunitetit me 206% realizim ndaj planit, ku përfshihen fondet e rindërtimit. Funksioni me realizim më ulët në 2021 është “Mbrojtja” me 92% kundrejt planit.³

Le të shohim tani të hyrat në buxhetin e shtetit për të njëjtin vit, 2021.

Sipas “Treguesit fiskale sipas buxhetit të konsoliduar 2021”⁴, të ardhurat totale janë në vlerën e 510.572 miliardë lekë dhe ndahen sipas të ardhura nga ndihmat (në masën 2%), të ardhurat tatimore (93%) dhe të ardhurat jo-tatimore (4%). Ngjan një shifër e pakuptueshme: 510,572,000,000! Është e vështirë që gjithsecili të dallojë “kontributin” personal në këtë shifër të buxhetit të përbashkët dhe është gati e pamundur të llogaritet se sa orë, ditë apo muaj pune janë bërë jo për të krijuar të ardhura për vete, por për të paguar buxhetin e shtetit. Në përpjekje për të ndërgjegjësuar publikun për taksat që paguajnë, çdo vit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës llogaritet një datë nga fillimi i vitit, pas të cilës thuhet se qytetari ka punuar mjaftueshëm për të paguar taksat e atij viti. Një vlerësim i përafërt bazuar mbi parimin e ditës së lirisë nga taksat duke marrë në konsideratë pagën mestare në Shqipëri si dhe duke trajtuar vetëm detyrimet tatimore që lindin nga punësimi, vlerësohet se dita e lirisë është me 16 Mars. Kjo do të thotë që një shqiptari me pagë mesatare i duhet të punojë deri me datë 16 Mars për të shlyer detyrimet tatimore që lindin nga punësimi. [\[link\]](#)

Nëse detajohemi më shumë tek të ardhurat tatimore, ndahen në tre grupime kryesore: të ardhura nga tatimet dhe doganat (71%), nga pushteti vendor (6%) si dhe të ardhura nga fondet speciale (23%). Pra nga rreth 338 miliardë lekët që shqiptarët paguan taksa dhe tatime (gjatë vitit 2021), 48% ose 161 miliardë lekë ishin Tatim mbi Vlerën e

³ "Konsolidimi I Buxhetit Faktik Sipas Funksioneve Viti 2021." *Open Data Albania*, 28 Jan. 2023, ndiqparate.al/?p=18791.

⁴ [treguesit-fiskal-12-2021-publikimi-perfundimtare.pdf \(financa.gov.al\)](#)

Shtuar. Rreth 15% ose 51 miliardë lekë janë akciza, të cilat rëndojnë kryesisht çmimet e naftës dhe të cigareve. Në shumicën e vendeve, tatimi mbi të ardhurat zë 20%, 30% apo 40% të të ardhurave totale të qeverisë, ndërsa në Shqipëri zërreth 12%. Por, TVSH-ja dhe akcizat janë në proporcion shumë më të lartë si përqindje e taksave kombëtare se sa tatimi mbi të ardhurat personale.

II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	338.074	71%
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	161.536	48%
a.	T.V.SH e arketuar	185.639	
b.	T.V.SH e Rimbursuar	24.102	
2	Tatimi mbi Fitimin	35.610	11%
3	Akcizat	51.637	15%
a.	Akciza e arketuar	51.962	
b.	Akciza e rimbursuar	325	
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	39.312	12%
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	42.521	13%
6	Taksa Doganore	7.457	2%
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	26.666	6%
1	Takse mbi Pasurine	6.116	23%
2	Biznesi i vogel	385	1%
3	Taksa Lokale	20.166	76%
II.3	Te ardh nga fondet speciale	110.872	23%
1	Sigurimi Shoqeror	94.900	86%
2	Sigurimi Shendetsor	14.541	13%
3	Fondi i kompesimit te pronareve	1.431	1%

3. Informimi mbi taksat e vendit

3.1 Llojet e taksave dhe tarifave

Taksat dhe tarifatat lindin dhe paguhen nga çdo person, i cili ushtron një të drejtë apo merr një shërbim publik. Taksat janë pagesa për buxhetin e shtetit, por që në këmbim mund të mos lidhen me një përfitim shërbimi specifik për individin apo biznesin që i paguan ato. Nisur nga fakti që taksa është e detyrueshme për t'u paguar, ajo është e llogaritur që të shërbejë jo sipas thjesht emërtimit të saj, por sipas nevojave të buxhetit të shtetit.⁵

Tarifata janë më ngushtë të lidhura me një shërbim apo përfitim nga individi që i paguan. Tarifa është një pagesë direkte që në këmbim i jep paguesit një avantazh apo garanci nga pushteti (vendor apo qendror) për paguesin e tarifës. Shuma e tarifës llogaritet duke u

⁵ Taksimi, leksione të përditësuara për sistemin tatimor shqiptar, 2018

bazuar në shpenzimet që qeveria (vendore apo qendrore) do të kryejë për të dhënë shërbimin që është objekt tarifimi dhe me këtë bazë llogaritje bëhet edhe përcaktimi i shumës që duhet të paguhet nga personat që duhet të paguajnë tarifën.

Taksat mund të kenë shtrirje sipas një territori të një njësie të qeverisjes vendore duke u emërtuar në këtë rast si taksa apo tarifa vendore dhe aplikohen sipas autoritetit të qeverisë vendore, por mund të kenë edhe shtrirje kombëtare dhe në këtë rast emërtohen si taksa kombëtare. Po ashtu, tarifat kanë shtrirje në nivel njësie qeverisjeje vendore, si edhe në nivel kombëtar.

Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore. Në tatimet dhe taksat kombëtare përfshihen:⁶

- tatimi mbi vlerën e shtuar;
- tatimi mbi të ardhurat (përfshin tatimin mbi fitimin, tatimin mbi të ardhurat personale);
- tatimi mbi të ardhurat personale nga lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet;
- akcizat mbi mallrat dhe produkte të përcaktuara në ligjin specifik;
- taksat dhe tarifat kombëtare;
- tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave individuale

Taksat dhe tarifat vendore janë:

- Për bizneset: Taksa e Hotelit, Taksa mbi Ndërtesën, Taksa e Reklamës, Taksa e Tokës Bujqësore, Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore (vetëm Bashkia Tiranë), Taksa e tabelës informuese, Taksa mbi truallin, Tarifa e pastrimit, Tarifa e Zënies së Hapësirës Publike.

⁶ ALTAX, aksesuar online në: [Cilat janë tatimet dhe taksat që paguhet në Shqipëri? - ALTAX](#)

	Vendore	Kombëtare
Taksë	Taksa mbi tokën bujqësore, taksa mbi truallin, taksa mbi ndërtesën, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa e fjetjes në hotel, taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve etj.	Taksa e mjeteve të përdorura, taksa portuale, taksa e rentës minerare, taksa e akteve dhe pullës, taksa për automjete luksozë, taksë regjistrimi fillestar për automjetin, taksë mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror etj.
Tarifë	Tarifa e pastrimit, tarifa për mjetet e transportit (parkim, shërbim për tonazh, tarifa për dhënie leje për ushtrim aktivitetit, tarifë për shërbime veterinare, tarifa për shërbime urbanistike, për shërbime administrative, tarifa e zënies së hapësirës publike etj.	Tarifa e pajisjes me leje drejtimi automjeti, tarifa shërbimi konsullor, tarifa për shërbime nga sistemi drejtësisë, tarifa për transmetimet radiotelevizive etj.

- Për individët dhe familjet: Taksa mbi ndërtesën, Taksa mbi tokën bujqësore, Taksa mbi truallin, Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore (vetëm Bashkia Tiranë), Tarifë Pastrimi dhe Largimit të mbeturinave.

Paratë e mbledhura nga një tarifë, si rregull ndërkombëtar janë të ndara në buxhet posaçërisht për qëllimin e shërbimeve për të cilat është vendosur (emërtuar) tarifa dhe nuk shkrihen bashkë me të ardhurat e tjera të buxhetit të shtetit. Kjo lidhje mes tarifës dhe shërbimit të kryer e bën atë të dallueshme nga taksa.

Taksa vendore paguhet në buxhetin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, nga çdo person që ushtron një të drejtë apo përfiton një shërbim publik në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Ndërsa taksa kombëtare është pagesa e detyrueshme dhe e pakthyeshme në Buxhetin e Shtetit që paguhet nga çdo person apo nëpërmjet një agjenti, pavarësisht vendndodhjes ku jeton dhe punon personi (qytetar apo fshatar).

3.2 Qytetarët përballë taksave

Sipas një ankete të realizuar nga CoPlan⁷ dalin në pah një sërë problematikash në lidhje me marrëdhënien e qytetarëve, taksave dhe pushtetit përgjegjës. Pavarësisht se qytetarët kanë detyrim të paguajnë një sërë taksash dhe tarifash vendore çdo muaj, disa nga rezultate janë si më poshtë:

- 23% e të anketuarëve nuk kanë asnjë informacion se çfarë taksash paguajnë, rrjedhimisht vetëm 72% janë relativisht të njohur me detyrimet që kanë.
- 92% e qytetarëve të anketuar deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në një dëgjese publike. Kjo tregon mungesën e transparencës së bashkive dhe organizimi i dëgjësive publike.
- 49% shprehen për **paqartësi mbi çfarë taksash paguhen, mënyrën e pagesës së tyre dhe mungesë të njohurive në lidhje me mënyrën e llogaritjes së detyrimeve vendore**, ku 49% nuk e kanë idenë se si bëhet llogaritja dhe për pasojë një pjesë e madhe e tyre nuk ka bërë ndonjëherë kërkesë për korrigjim të dhënash apo ankesë për detyrimet vendore.
- Referuar raportit, **një nivel i lartë i njohurive mbi detyrimet vendore** vlerësohet se do të kontribuonte pozitivisht në qasjen e taksapaguesve ndaj detyrimeve vendore, do të përmirësonte mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, faktor ky thelbësor për financa të shëndetshme në nivel vendor dhe shërbime publike cilësore për qytetarët.
- 83% e të intervistuarve janë shprehur se niveli i detyrimeve vendore perceptohet të jetë i lartë çka kufizon aftësinë e tyre paguese. Si e tillë rezulton shqetësues fakti se afro gjysma e qytetarëve shprehen se nesë do të kishin mundësi dhe hapsirë, do të shmangeshin pagesës së detyrimeve, edhe pse aktualisht rezulton se 13% nuk paguajnë.

Gjatë vitit që lamë pas, një nga temat më të përfolura ishte rritja e jashtëzakonshme e çmimit të karburantit dhe si rrjedhim për shkak të debatit publik, një pjesë e mirë u njohën me faktin se paguajmë rreth 7 taksa mbi naftën. **Në çdo litër naftë që shitet në treg, qeveria shqiptare mbledh 37 lekë akcizë, 27 lekë taksë qarkullimi, 3 lekë taksë karboni dhe 7 deri në 10 lekë taksë rilicencimi.**

Këtyre katër taksave që shkon në buxhet u shtohen dy taksa të tjera që paguhen për koncesionarët privatë. Ato janë **taksa e markimit 1**

⁷©Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Aksesuar online: [Perceptimi Qytetar mbi Taksimin Vendor dhe Shërbimet Publike – Co-PLAN](#)

lekë për litër dhe skanimi 1.4 lekë për litër. Në fund, pas këtyre 6 taksave paguhet edhe tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), i cili është 20% e çmimit final, ose rreth 30 lekë për litër. Kjo e çon barrën totale të taksave në një litër naftë 109.4 lekë për litër.

Nëse e shohim pjesën e taksave nga ana e pagave, një person merr pagë në masën 40'000 lekë (neto), taksat totale që paguan vetëm punëmarrësi (i punësuar) çdo muaj 5'178 lekë, përkatësisht për sigurimin shëndetësor dhe shoqëror që i ofron shteti (4'392 për sigurimin shoqëror dhe 785 për sigurimin shëndetësor) dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi në vlerën e 1055 lekëve. (Llogarit pagën neto ose bruto [Link](#))

Shohim pagën mesatare në vlerën 57'182, taksat totale mbi këtë pagë janë 9938 lekë, të ndara si më poshtë: 5'432 lekë sigurime shoqërore, 972 lekë sigurime shëndetësore dhe 3'534 lekë tatim mbi të ardhurat personale. Për ta përmbledhur disa nga ato çfarë diskutuam më sipër. Nëse ke të ardhura neto nga paga në masën 100 mijë lekë në muaj, mbi këto të ardhura ka gjasa ke paguar sigurime dhe TAP rreth 12'000 lekë. Për çdo lek ushqime që blen me këto të ardhura paguan 20% TVSH dhe nëse konsumon karburant apo cigare, taksat që paguan rriten në më shumë se 20%. Pjesa e mbetur është vlera e mallrave që realisht konsumon.

Në këtë mënyrë, në rast se secili do të arrinte të bënte llogaritë dhe të kuptonte në vlerë reale se sa i kushton në muaj, vit apo gjithsej vite punë kontribut vetëm për sigurimin shoqëror dhe shëndetësor apo pagesa për tatimin mbi fitimin nga të ardhurat mbi punësimin (që i ndan mes konsumit personal dhe buxhetit të shtetit) do të ndryshonte të paktën qëndrimin ndaj shtetit dhe autoriteteve përkatëse. Së bashku me informimin supozohet që të rritet ndërgjegjësimi për çdo vepër/aktivitet që ndodh në komunitet dhe më gjerë. Qytetarët do të ishin më "të interesuar" për shërbimin shëndetësor që marrin në klinikën e lagjies apo nëpër spitale, më të përditësuar me pensionet dhe ndihmat e ndryshme shoqërore. Një taksapagues nuk mund të tregohet indiferent por duhet të ketë një rol aktiv në komunitet, të ketë interes të informohet për mirëmbajtjen e rrugëve të lagjies, cilësinë e ujit dhe tokës, menaxhimin e mbeturinave, shkollën, dritat e qytetit dhe shumë shërbime të tjera për të cilat paguan dhe kontribuon.

Pra, kur qytetarët nisin të ndërgjegjësohen dhe të vetëdeklarojnë të ardhurat e tyre te autoritetet dhe të paguajnë tatim mbi këto të ardhura, kuptojnë që ato vetë janë blerësit e shërbimeve publike dhe si blerës kanë "pronësinë" mbi qeverisjen e vendit; që do të thotë se kanë të drejtë të kërkojnë llogari se si përdoren taksat e tyre.

Problemi kryesor është që shumica e taksimit në Shqipëri sot është indirekt, në formën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar dhe të akcizave (si dhe të TVSH-së së mbajtur mbi akcizat) dhe rrjedhimisht, pjesa dërrmuese e popullsisë është e pandërgjegjshme për taksat që paguan.

4. Paketa fiskale 2023

Si çdo vit, bashkë me buxhetin e shtetit diskutohen disa ligje mbi taksimin e shqiptarëve, të cilat hapin debate që nxjerrin në pah një mungesë të thellë të të kuptuarit të taksave.

Politika fiskale janë mjetet dhe mënyrat nëpërmjet të cilave qeverisja rregullon nivelin e shpenzimeve publike dhe të ardhurave fiskale (normave fiskale dhe rregullave të tjera) për të monitoruar dhe ndikuar në ekonominë e atij shteti. Kjo është strategjia simotër e politikës monetare, e cila përdoret nga Banka Qendrore, nëpërmjet së cilës ndikohet oferta e parasë së një shteti. Të dyja këto politika monitorohen me kujdes për të parë se si ndikojnë në ekonominë e një shteti. Disa nga pikat më të rëndësishme të Paketës Fiskale 2023, janë si më poshtë:

- Paketa Fiskale 2023 synon të rrisë mirë-administrimin e të ardhurave dhe të përafrojë legjislacionin tatimor me direktivat e Bashkimit Europian, ashtu si edhe të reflektojë disa korrektime në ligjet aktuale, sipas rekomandimeve të FMN dhe diskutimeve me grupet e interesit.
- Lidhur me ndryshimet e propozuara në ligjin për Procedurat Tatimore, u theksua fakti se ato janë bërë duke marrë në konsideratë edhe zërin e qytetarëve përmes Këshillimit Kombëtar.
- Qasja ka të bëjë në mënyrë eksplicite me masat që kryesisht lidhen me luftën kundër informalitetit në tregun e punës, ku konstatohen raste të të punësuarve janë të disavantazuar krahas punëdhënësve sa i përket zbatimit të kontratave të punës. Ndërrhyrje për ashpërsimin e masave për rastet kur evidentohen mosdeklarime punonjësish, fshehje e pagave apo edhe mosdeklarim të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
- Nga ana tjetër është parashikuar ashpërsim të penalteteve për rastet e moshoqërimit të mallrave me faturë, por kjo vetëm për rastet e biznesit të madh sepse kjo lë hapësira për evazion (gjoba).
- Disa incentiva lehtësuese: Ndryshimet në akcizën e birrës, përjashtimin nga TVSH-ja të projekteve për fondet IPA,

përrjashtimin nga TVSH-ja për atë çka do të trajtohet nëpërmjet bursës së energjisë. Apo edhe përrjashtimin e druve të zjarrit dhe paletave në import, po ashtu edhe në tregun e brendshëm, si një masë ndihmëse për qytetarët në kushtet kur po përrpiqemi të mbajmë të pandryshuar çmimet e energjisë dhe të subvencionojmë qytetarët dhe bizneset e vogla.

- Konsolidimi i financave publike, rritja e të ardhurave të buxhetit të shtetit, dhe ulja graduale e deficitit buxhetor vazhdojnë të jenë objektivat kryesorë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Interpretim:

Ajo çfarë vihet re nga paketa e fundit fiskale për vitin 2023 është që nuk përrqendrohet apo nuk merr në konsideratë situatën aktuale ekonomike që po kalon vendi (niveлин e inflacionit dhe pasigurive në shumicën e sektorëve ekonomikë) por ka zgjedhur që përrmirësimin e situatës ta mbështesë mbi shtimin e penaliteteve ndaj subjekteve tatimore. Pra, në vend të lehtësirave kemi marrje masash shtrënguese (ritje e arbitraritetit) dhe ndryshime relativisht të pjesëshme (sic janë vijimi i rekomandimeve të FMN-së për më shumë barazi tatimore dhe ritje e disiplinës fiskale duke krijuar një ritje të jashtëzakonshme të penaliteteve fiskale (mos lëshim faturash, mos zbatim të afateve kohore, etj) dhe jo thelbësore. Megjithatë pavarësisht vendosjes së penaliteteve suksesi dhe eficaenca e kësaj politike do të varet nga disiplina fiskale dhe efikasiteti i administratës tatimore. Gjithashtu, një ndryshim me peshë lidhet me ndryshimet në akcizën për industrinë e pijeve alkolike e cila duke barazuar prodhuesit e vegjël me prodhuesit e mëdhenj, disfavorizon prodhuesit e brendshëm përrballë kompanive shumëkombëshe. Sistemi tatimor duhet të synojë qartësi, qëndrueshmëri, ritje të efikasitetit të administratës tatimore në marrëdhënie me biznesin.

5. Përfundime

- Sistemi fiskal dhe financiar (tatimor) i Shqipërisë mund të ndahet tre periudha historike: Krijimi i shtetit shqiptar dhe qeverive pas tij 1912-1944; pezullimi i sistemit tatimor (1945-1990); dhe rifillimi i sistemit modern tatimor (1991- 2012).
- Sektori me peshën më të lartë në shpenzimet buxhetore është “Mbrojtja Sociale, me 30% të shpenzimeve publike në vitin 2021, ku mbulohen programe si fondi i pensioneve, mbështetja e familjeve dhe individëve në nevojë. Kategoria “Shërbime të përgjithshme publike” 15% të shpenzimeve buxhetore të konsoliduara. Funkcionet “Çështjet ekonomike” dhe “Strehimi komoditetet e komunitetit” (fondet e rindërtimit) zënë respektivisht 11% dhe 12%, “Shëndetësia” dhe “Arsimi” përbëjnë respektivisht 11% dhe 10% të shpenzimeve publike. “Rendi dhe Siguria Publike” me 6%, “Mbrojtja” 2%, “Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare” dhe “Mbrojtja e mjedisit” me vetëm 1% secila.
- Sipas “Treguesit fiskale sipas buxhetit të konsoliduar 2021”⁸ të ardhurat totale janë në vlerën e 510.572 miliardë lekë dhe ndahen sipas të ardhura nga ndihma (në masën 2%), të ardhurat tatimore (93%) dhe të ardhurat jo-tatimore (4%). Nëse detajohemi më shumë tek të ardhurat tatimore, ndahen në tre grupime kryesore: të ardhura nga tatimet dhe doganat (71%), nga pushteti vendor (6%) si dhe të ardhura nga fondet speciale (23%). Pra nga rreth 338 miliardë lekët që shqiptarët paguan taksa dhe tatime (gjatë vitit 2021), 48% ose 161 miliardë lekë ishin Tatim mbi Vlerën e Shtuar. Rreth 15% ose 51 miliardë lekë janë akciza, të cilat rëndojnë kryesisht çmimet e naftës dhe të cigareve.
- Sipas një ankete të realizuar nga CoPlan⁹ 23% e të anketuarëve nuk kanë asnjë informacion se çfarë taksash paguajnë, 92% e qytetarëve të anketuar deklarojnë se nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në një dëgjese publike, 49% shprehen se nuk e kanë idenë se si bëhet llogaritja dhe për pasojë një pjesë e madhe e tyre nuk ka bërë ndonjëherë kërkesë për korrigjim të dhënash apo ankesë për detyrimet vendore. 83% e të intervistuarve janë shprehur se niveli i detyrimeve vendore perceptohet të jetë i

⁸ [treguesit-fiskal-12-2021-publikimi-perfundimtare.pdf \(financa.gov.al\)](https://www.financa.gov.al/treguesit-fiskal-12-2021-publikimi-perfundimtare.pdf)

⁹©Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit. Aksesuar online: [Perceptimi Qytetar mbi Taksimin Vendor dhe Shërbimet Publike – Co-PLAN](#)

lartë çka kufizon aftësinë e tyre paguese. Si e tillë rezulton shqetësues fakti se afro gjysma e qytetarëve shprehen se nesër do të kishin mundësi dhe hapsirë, do ti shmangeshin pagesës së detyrimeve, edhe pse aktualisht rezulton se 13% nuk paguajnë.

- Nëse ke të ardhura neto nga paga në masën 100 mijë lekë në muaj, mbi këto të ardhura ka gjasa ke paguar sigurime dhe TAP rreth 12'000 lekë. Për çdo lek ushqime që blen me këto të ardhura paguan 20% TVSH dhe nëse konsumon karburant apo cigare, taksat që paguan rriten në më shumë se 20%. Pjesa e mbetur është vlera e mallrave që realisht konsumon.
- Paketa e fundit fiskale për vitin 2023 nuk merr në konsideratë situatën aktuale ekonomike që po kalon vendi (nivelin e inflacionit dhe pasigurive në shumicën e sektorëve ekonomikë), në vend të lehtësirave kemi marrje masash shtrënguese dhe ndryshime relativisht të pjesëshme. Ndonse kemi vendosje penalitetesh suksesi dhe efica e kësaj politike varet nga disiplina fiskale dhe efikasiteti i administrates tatimore.

Bibliografia:

"Paketa Fiskale 2023 Rrit Presionin Fiskal Mbi Prodhuesit." YouTube, ngarkuar nga Revista Monitor, 21 Tet. 2022, youtu.be/CESQkCa0yig.

"Taksat Vs. Tarifat Në Shqipëri." *Altax.AL*, 22 Shtator, altax.al/taksat-vs-tarifat-ne-shqiperi/.

"TATIMET SHQIPTARE NË 100 VITE (1912-2012)." *Monitor.AL*, 22 Dhj. 2012, www.monitor.al/tatimet-shqiptare-ne-100-vite-1912-2012-3/.

PERCEPTIMI QYTETAR MBI TAKSIMIN VENDOR DHE SHËRBIMET PUBLIKE.
©Co-PLAN, Instituti Për Zhvillimin E Habitatit, 2022.

Taksimi, Leksione Të Përditësuara Për Sistemin Tatimor Shqiptar, 2018.
Urtesia Bektashiane, 2018.

"Konsolidimi I Buxhetit Faktik Sipas Funksioneve Viti 2021." *Open Data Albania*, 28 Jan. 2023, ndiqparate.al/?p=18791.

"Treguesit fiskal sipas buxhetit te konsoliduar 2021." financa.gov.al, 20 Maj 2022, www.financa.gov.al/ep-content/uploads/2022/05/treguesit-fiskal-12-2021-publikimi-perfundimtare.pdf.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al